

VENDIM
Nr. 91, datë 24.4.2025

MBI MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 254, DATË 23.8.2023, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘G.S.K’ SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; dhe të nenit 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.4.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 1544/2 prot., datë 23.4.2025, “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 254, datë 23.8.2023 ‘Mbi licencimin e shoqërisë “GSK” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, i ndryshuar”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “G.S.K” sh.p.k. është licencuar nga Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 254, datë 23.8.2023, për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar prej 2 mw, për një afat 25-vjeçar. Shoqëria ka detyrimin të informojë ERE-n çdo tre muaj mbi ecurinë e punimeve për ndërtimin e centralit, deri më 23.6.2024. Ky vendim është objekt rishikimi nga ana e ERE-s, në varësi të dorëzimit të informacionit të kërkuar, në kuadër të vlefshmërisë së VNM-së paraprake.

1. Ndryshimi i kushteve me vendim të mëvonshëm të Bordit

- Duke marrë parasysh përfundimin e afatit të vlefshmërisë së VNM-së paraprake dhe në bazë të sqarimeve të dhëna nga shoqëria për aplikimin për pajisjen me një VNM të re, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 151, datë 25.7.2024, ka ndryshuar pikat 2 dhe 3, të vendimit nr. 254/2023 si më poshtë:

Pika 2 (e ndryshuar): “Përpara fillimit të operimit/ushtrimit të veprimtarisë së energjisë elektrike, shoqëria “G.S.K” sh.p.k. të depozitojë në ERE, VNM-në e rinovuar”. **Pika 3 (e ndryshuar):** “Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.”

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- Shoqëria “G.S.K” sh.p.k., me shkresën nr. 61/2 prot., datë 12.8.2024, protokolluar me tonën me nr. 781/6 prot., datë 12.8.2024, ka depozituar në ERE **VNM-në paraprake të re** me vlefshmëri 2-vjeçare, dhe më pas, me shkresën nr. 61/4 prot., datë 27.11.2024, protokolluar me tonën me nr. 781/10 prot., datë 27.11.2024, ka paraqitur në ERE **lejen e ndërtimit** për objektin “Ndërtimi i Centralit Gjenerues të Energjisë Elektrike Fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 2mw dhe veprave ndihmëse”, lëshuar nga Këshilli Kombëtar i Territorit me vendimin nr. 25, datë 4.6.2024.

- Me shkresën nr. 49 prot., datë 15.4.2025, protokolluar me tonën me nr. 1544 prot., datë 15.4.2025, shoqëria ka paraqitur në ERE kërkesën për rishikimin e vendimit të Bordit nr. 151, datë 25.7.2024, duke paraqitur procesverbalin e fillimit dhe përfundimit të punimeve, sipas të cilit: Punimet kanë filluar më 19.12.2024, brenda afatit 90-ditor nga data e lejes së ndërtimit (25.11.2024). Punimet kanë përfunduar më 10.2.2025, brenda afatit 3-vjeçar të përcaktuar në kontratën me MIE-n, datë 13.7.2023.

3. Vlerësimi për përmbushjen e kushteve

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe i afateve të kontratës me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, rezulton se shoqëria “G.S.K” sh.p.k. ka respektuar: Afatin për **fillimin e punimeve** (brenda

90 ditëve nga pajisja me leje ndërtimi). Afatin për **përfundimin e punimeve** (brenda 36 muajve nga pajisja me të gjitha lejet përkatëse). Afatin 2-vjeçar për **fillimin e zbatimit të projektit** sipas vlefshmërisë së VNM-së së re të lëshuar nga AKM-ja.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Bazuar në nenin 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, citojmë se: *“Plotësimi ose mosplotësimi i kushtit, sipas përvaktimit në vendimin e Bordit të ERE-s, do të përbëjë shkak për rishikimin e vendimit.”*

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pikat 2 dhe 3, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 254, datë 23.8.2023, të ndryshuara me vendimin nr. 151, datë 25.7.2024, shfuqizohen.

2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “G.S.K” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti